

VENDIM
Nr.1315, datë 1.10.2008

PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE TË SHITESAVE MBI PAGËN TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN, QË SHËRBEJNË SI NËPUNËS NDËRLIDHËS, PRANË QENDRËS SECI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit shqiptarë, të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë së Financave, për kohën, që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës, pranë Qendrës SECI, trajtohen me pagë për gradë dhe shtesë për përfaqësim, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Për efekt të këtij trajtimi, paga e nëpunësve ndërlidhës, njehsohet me pagën e gradës “Këshilltar”, në shërbimin e jashtëm.

2. Nëpunësit ndërlidhës, për kohën që shërbejnë pranë Qendrës SECI, përfitojnë edhe kompensim për koston e jetesës, në masën 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro.

3. Paga e nëpunësit ndërlidhës fillon nga data e mbërritjes së tij pranë Qendrës SECI. Deri në këtë çast, ai trajtohet me pagën ekzistuese të vendit të tij të mëparshëm të punës.

4. Paga mujore i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale, sipas legjislacionit në fuqi. Në bazë të pagës mujore paguhen edhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

5. Paga mujore i nënshtrohet rishikimit, në të njëjtën formë, si të gjitha kategoritë e tjera të pagave në Republikën e Shqipërisë.

6. Pikat 7 e 8 të vendimit nr.129, datë 15.3.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në Qendrën Rajonale të Nismës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra SECI), për luftën kundër krimit ndërkufitar”, shfuqizohen.

7. Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave, brenda fondeve buxhetore vjetore, të parashikuara në ligjin e buxhetit të vitit përkatës kalendarik, të përballojnë shpenzimet për pagat e nëpunësve ndërlidhës.

8. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

PAGA MUJORE E NËPUNËSVE NDËRLIDHËS TË MINISTRISË SË BRENDSHME E TË MINISTRISË SË FINANCAVE PRANË QENDRËS SECI

Pozicioni	Paga mujore	
	Paga bazë mujore në euro	Shtesë për përfaqësimin në %
Nëpunës	780 euro	40%

ndërlidhës		
------------	--	--